

URDHËR
Nr.82, datë 19.6.2008

PËR MIRATIMIN E PRIMIT TË PASTËR TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORIKE PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE
TË TRETA

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, i ndryshuar”, të rregullores së datës 7.5.2002 “Për disa shtesa në rregulloren nr.622/1, datë 15.12.1992 “Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, të nenit 100 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

URDHËROJ:

1. Primi i pastër për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për kontratat TPL e brendshme, me afat njëvjeçar, të jetë si më poshtë:

Kat	Klasa	Tipi	Kapaciteti motorik (cm ³) ose pesha bartëse (ton) ose numri i vendeve	Primi i pastër (në lekë)
A 1		Motoçikleta	Kapaciteti motorik	
	A 1/1		Deri në 150 cm ³	2.600
	A 1/2		Mbi 150 cm ³	4.400
B 1		Autovetura	Kapaciteti motorik	
	B 1/1		Deri në 1600 cm ³	6.300
	B 1/2		Mbi 1600 cm ³	9.200
B 2		Furgona, mikrobuzë	Nr. i vendeve	
	B 2/1		Nga 5 deri në 8 vende	12.700
	B 2/2		Mbi 8 deri në 15 vende	17.500
C 1		Autobusë	Mbi 15 vende	28.000
D 1		Kamionçina	Pesha mbajtëse deri në 3.5 ton	12.300
D 2		Kamionë	Pesha mbajtëse mbi 3.5 ton	20.400
E		Rimorkio	Të të gjitha llojeve	5.900
F		Mjete bujqësore		4.600
G		Zjarrfikëse		10.500

2. Primi i pastër i sigurimit të detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për kontratat kufitare të sigurimit, të jetë si më poshtë:

Kat	Tipi i mjetit	Primi në euro					
		15	20	25	30	45	Njëvjeçare

		ditore	ditore	ditore	ditore	ditore	
A	Autovetura	17	21	24	28	31	150
B.1	Motoçikleta	8	10	12	14	17	60
B.2	Motokarro	10	14	17	21	24	75
C.1	Kamion për mallra nga 15 deri 34.99 Kv	56	70	84	91	105	240
C.2	Kamion për mallra nga 35 Kv e lartë	70	84	91	105	126	400
D	Ciklomotor	8	10	12	14	17	60
E	Autobusë	98	112	133	147	174	400
F.1	Rimorkio kamioni	42	49	56	63	77	100
F.2	Rimorkio autobusi	56	63	70	77	98	150
F.3	Rimorkio të tjera	21	28	35	42	49	100

3. Provigjoni i primit të pafituar të llogaritet për çdo policë sigurimi, si pjesë proporcionale e primit të pastër, të përcaktuar në këtë urdhër, për periudhën e paskaduar të policës së sigurimit.

4. Moszbatimi i primit të pastër, të përcaktuara në këtë urdhër, i bën shoqëritë e sigurimit subjekt të sanksioneve të përcaktuara në nenin 165 e vijues të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar.

5. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe Byroja Shqiptare e Sigurimit për zbatimin e këtij urdhri, i cili është subjekt mbikëqyrjeje nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

6. Me fillimin e efekteve të këtij urdhri, shfuqizohet urdhri i Ministrisë të Financave nr.70, datë 20.7.2007 “Për miratimin e primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet nga data 15.8.2008.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode